

Nr. 133 Prot

Tiranë, 09/02/2026

Drejtuar: Z. Blendi Gonxhja,
Ministër i Turizmit Kulturës dhe Sportit
Ministria e Turizmit Kulturës dhe Sportit

Lënda: Dërgohet aplikimi për thirrje për projekt propozime në fushën e sportit 2026

I nderuar Z. Blendi Gonxhja,

Në vijim të thirrjes për projekt propozime në fushën e sportit për vitin 2026, si dhe në zbatim të Urdhërit Nr. 65, datë 28/01/2026 për shpalljen e thirrjes për projekt-propozime, lutemi gjeni bashkëngjitur formularin e aplikimit të Federatës Shqiptare të Sportit Universitar dhe dokumentat e kërkuara për aplikim:

- 1- Projekt-propozimet e miratuara me Vendim të Komitetit Ekzekutiv të FSHSU;
- 2- Vërtetim datë 08.01.2026 nga Zyra e OJF-ve të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ku pasqyrohen të gjitha Vendimet e Federatës Shqiptare të Sportit Universitar;
- 3- Kopjen e Statutit dhe Vendimit të Gjykatës për regjistrimin e FSHSU;
- 4- Dokumentacionin që vërteton regjistrimin e federatës si person juridik;
- 5- Referuar **Urdhër të ministrit** përgjegjës për sportin **për miratimin e statutit** dhe ndryshimeve në fuqi, ju bëjmë me dije se prej datës 14.02.2025, FSHSU ka depozituar 3 (tre) kopje të statutit të ndryshuar sipas përshtatjeve dhe sugjerimeve të Ministrisë përgjegjëse për Sportin të kohës për miratim. Megjithatë, deri më sot, nuk kemi marrë ende Urdhrin përkatës për miratimin e tij;
- 6- Bilanci financiar;
- 7- Të dhënat e llogarisë bankare të nivelit të dytë;
- 8- Raporte financiare periodike për fondet publike.

Gjithashtu, duke qenë se projekti i parë për të cilin FSHSU kërkon mbështetjen e Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit është Kampionati European Universitar i Sporteve Luftarake – Tirana 2026, bashkëngjitur gjeni edhe letrat e mbështetjes nga aktorët institucionalë dhe partnerët e përfshirë në organizimin e këtij eventit prestigjioz ndërkombëtar, i cili do të zhvillohet në Tiranë në muajin shtator 2026.



Në përfundim, shprehim vullnetin tonë për bashkëpunim të vazhdueshëm institucional dhe angazhimin e FSHSU për garantimin e standardeve më të larta organizative, financiare dhe të transparencës në zbatimin e projekteve të mbështetura.

Me respekt,

Besnik Veliu

PRESIDENT

